

## Ftesë publike për qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e qytetarëve për pjesëmarrje në #SfidënLTL

New Social Initiative (NSI) hap Thirrje Publike për qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, shoqatat dhe grupet joformale që të marrin pjesë në **#SfidaLTL**.

A keni ndonjë ide inovative për të zgjidhur një problem në komunitetin tuaj lokal? **Ne kemi mjete për t'ju ndihmuar me këtë!**

Dëshironi të rregulloni një hapësirë publike në qytetin, fshatin apo lagjen tuaj (fushë për basketboll, futboll, volejball apo kënd lojërash)?

Dëshironi të organizoni ekspozita të artistëve vendas, festivale ushqimore ose të vizitoni vendet fetare dhe kulturore?

Apo ndoshta dëshironi të zhvilloni një aplikacion telefoni celular ose zgjidhje tjetër dixhitale që krijon ndikim social dhe kontribuon në zgjidhjen e çështjeve të komunitetit lokal?

MBLEDHNI EKIPIN ME TË CILIN DËSHIRONI TË ZBATONI IDEN dhe regjistrohuni në **#SfidaLTL**.

### ÇFARË ËSHTË #SfidaLTL

#SfidaLTL është një iniciativë e dedikuar kryesisht për qytetarët të cilët nuk duan të jenë vëzhgues pasiv të problemeve në komunitet e tyre, por janë të gatshëm të ofrojnë ide dhe zgjidhje:

#SfidaLTL fillon në shtator dhe zgjatë deri në nëntor 2022, kjo sfidë përfshinë:

- #SfidaLTL, e cila fillon nga data **9 shtator deri më 9 nëntor 2022**, gjatë së cilës ekipet do të kenë mundësi të paraqesin idetë e tyre për zgjidhjen e problemeve në komunitet. Iniciativa e re Sociale (NSI) do të ofrojë mbështetje këshilluese dhe financiare për të gjitha ekipet në zbatimin e ideve të tyre.
- #LTLKosovoMeetUp do të mbahen nga data 28 shtator deri më 7 nëntor, 2022 në shtatë lokacione në mbarë Kosovën (Mitrovicë të Veriut, Mitrovicë të Jugut, Prishtinë, Prizren, Shtërpçë, Graçanicë dhe Gjilan). Qëllimi i MeetUps është të takojmë qytetarët, ekipet e pjesëmarrësve dhe të diskutojmë se çfarë mund të bëjmë së bashku për të ndër marrë iniciativa qytetare dhe për të zgjidhur disa nga problemet në komunitet.
- #LTLKosovo - punëtori për fituesit e sfidës për të përgatitur ekipin për të zbatuar idetë e tyre.

### PËR KË ËSHTË KJO THIRRJE?

Nëse jeni një person aktiv, keni ide për iniciativa lokale, apo jeni i/e përfshirë në punën e një organizate joqeveritare, pra një qytetar i vetëdijshtëm dhe që përballet me problemet në komunitetin tuaj lokal dhe i gatshëm për t'i marrë gjërat në duart tuaja, atëherë kjo është një mundësi për ju.

Mblidhni një ekip prej të paktën 4 personash, hulumtoni problemet në komunitetin lokal dhe aplikoni në **#SfidaLTL**.

Ju mund të aplikoni nëse plotësoni kërkesat e mëposhtme:

- Ekipi përbëhet nga të paktën 4 anëtarëve;
- Të gjithë anëtarët e ekipit duhet të jenë midis 15 dhe 60 vjeç;
- Anëtarët e ekipit janë të motivuar të marrin pjesë në #SfidaLTL;
- Të keni dëshirë për të kontribuar në ndërtimin e një mjedisi më të mirë për familjen, miqtë, fqinjët dhe bashkëqytetarët;
- dhe një ide se si ta bëni atë.

### SI MUND TË APLIKONI?

Nëse jeni të interesuar të merrni pjesë në #SfidaLTL, i përmbushni kriteret e mësipërme, dëshironi të tregoni se komuniteti juaj meriton ndryshim dhe ekipi juaj e meriton çmimin, përcjellin hapat e mëpotshëm.

1. Bëni një video, foto, shkruani një blog ose gjeni ndonjë mënyrë tjetër për të na prezantuar me ekipin tuaj, komunitetin lokal nga keni ardhur dhe na tregoni problemin që dëshironi të zgjidhni dhe të propozoni idenë tuaj për zgjidhjen e atij problemi si plan për realizimin e idesë tuaj.

**SHËNIM:** Ju duhet ta kryeni detyrën si ekip. Të gjithë anëtarët e ekipit duhet të shfaqen. Videoja nuk duhet të jetë më e gjatë se pesë minuta.

2. Regjistrohuni së bashku për sfidën duke përdorur formularin elektronik në linkun: <https://forms.office.com/r/RpEmHjwMUF>, ku do të dorëzoni videon, fotot, blogun ose propozimin me shkrim të idesë tuaj dhe buxhetin që ju nevojitet për të realizuar idenë tuaj.

**SHËNIM:** Shuma maksimale e buxhetit për projekt është 2000,00 €. Ju mund ta shkarkoni formularin e buxhetit [këtu](#).

Kërkesa jonë ndaj jush është që ideja juaj të jetë një tregues i qartë i problemit të komunitetit lokal, dhe një plan i mirë për zbatim.

# new social initiative

## LTLChangeInitiative



Në mënyrë që propozimet dhe idetë të merren parasysh, ato duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Nisma juaj do të zbatohet në territorin e komunitetit lokal nga vjen ekipi brenda një periudhë 3 mujore.
- Nisma juaj të jetë e qartë, konkrete, me synime dhe rezultate të dukshme.

**SHËNIM:** Iniciativat që zgjidhin probleme më të gjera të komunitetit dhe ekipet ndëretnike inkurajohen veçanërisht të marrin pjesë në sfidë.

Idetë duhet të adresojnë sfidat nga komuniteti brenda temave të mëposhtme:

- Rregullimi i zonave publike lokale
- Ekologji
- Kulturë
- Sport
- Vullnetarizim

**SHËNIM:** Ne duam që procesi të jetë transparent dhe komuniteti i gjerë të ketë qasje në votimin e idës më të mire për këtë arsye votimi do të bëhet edhe përmes kanaleve tona në facebook dhe instagram ku të gjitha idetë do të jenë të qashme për publikun e gjerë. Ju inkurajom që videon tuaj, fotot, blogun ose mënyrën e paraqitjes së ides tuaj në profilin tuaj në facebook dhe/ose në instagram dhe etiketoni kanalet tona në facebook dhe instagram në përshkrim ose përdorni mundësinë për të qenë bashkëpunëtorë duke përdorur opsionin (invite collaborator) kur publikoni.

Kanalet tona janë:

<https://www.facebook.com/ltlkosovo>

<https://www.instagram.com/ltlkosovo>

New Social Initiative (NSI) rezervon të drejtën të financojë ndonjë ose asnjë nga nismat qytetare vendore të paraqitura në rast se asnjë prej aplikimeve nuk i plotëson kriteret.


Për informacion shtesë na kontaktoni përmes emailit në [office@newsocialinitiative.org](mailto:office@newsocialinitiative.org) ose përmes kanaleve tona të mediave sociale

<https://www.facebook.com/ltlkosovo>

<https://www.instagram.com/ltlkosovo>

Aplikimi është i hapur deri më **9 nëntor ora 23:59**.

\* Programi mundësohet nga Iniciativa e Re Sociale me mbështetjen e Departamentit Federal të Zvicrës Punëve të Jashtme (FDFA) përmes Ambasadës së Zvicrës në Kosovë dhe Rockefeller Fondi Rockefeller Brothers (RBF)



Čika Jovina V/117, North Mitrovica  
+381 28 497180

[www.newsocialinitiative.org](http://www.newsocialinitiative.org)  
[ltl.newsocialinitiative.org](mailto:ltl.newsocialinitiative.org)

**Inspire Dynamic**  
**Communities**